VENDIM
Nr.9, datë 4.1.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KRUTJE TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, Brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Krutje të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 53 (pesëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 317 (treqind e shtatëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Krutje për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna, Krutje Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1 - 18	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
19 - 20/2	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
21 - 24	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
27-82, 279-303, 316	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e infrastrukturës (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbimeve publike.	Në pronësi
83 - 96	Varrezat publike	Në pronësi
97-133	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
134 - 139	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
254,256, 260, 262, 264, 266, 268 -271	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Sip. 52 ha, fshati Gjazë, i është dorëzuar AKKP-së	Në përdorim
164, 180, 196, 200, 209, 213 220, 234, 241, 246, 250, 253 255, 257, 258, 259, 261, 263 265, 267	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
272 - 278	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi